

PROF. ASOC. DR. SALI KADRIA

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë
kadriasali@gmail.com

**QËNDRIMI I SHTETIT SHQIPTAR NDAJ SHQIPTARËVE TË
KOSOVËS DHE VISEVE TË TJERA ETNIKE SHQIPTARE NË
JUGOSLLAVI TË ARDHUR NË SHQIPËRI GJATË VITEVE
1928-1929****Abstrakt:**

Në këtë artikull trajtohet qëndrimi i mbajtur nga shteti shqiptar ndaj shqiptarëve të shpërngulur nga viset e tyre etnike në Jugosllavi, të cilët u vendosën në Shqipëri gjatë viteve 1928-1929. Punimi nis me fillimet e ardhjes së shqiptarëve të viseve etnike shqiptare në shtetin amë, problemet e vështirësitë e ndeshura, si dhe mënyrën e trajtimit të tyre nga autoritetet e shtetit shqiptar. Artikulli sjell të dhëna të hollësishme për periudhën e marrë në shqyrtim, mbi procedurën e ndjekur nga Zyra Sekrete e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe prefekturat, në lidhje me shqiptarët e arratisur nga Jugosllavia që hynin brenda kufirit të shtetit shqiptar deri në vendin e instalimit përfundimtar të tyre. Po ashtu, në këtë artikull pasqyrohet qëndrimi i mbajtur nga ana e drejtuesve të prefekturave ndaj shqiptarëve që hynin në territorin e Shqipërisë përmes kufirit me Jugosllavinë, si dhe jepen të dhëna mbi vendet e Shqipërisë, në të cilat, shqiptarët e shpërngulur nga Kosova dhe viset e tjera etnike, kërkonin të vendoseshin për të rinisur jetesën e tyre.

Fjalë kyç:

Emigrantë shqiptarë, Shqipëri, Kosovë, Jugosllavi, Zyra Sekrete e Ministrisë së Punëve të Brendshme, prefektura e Kosovës, Drejtoria e Emigracionit.

Fillesat e shpërnguljes së shqiptarëve të viseve etnike shqiptare në drejtim të Shqipërisë dhe mënyra e trajtimit të tyre nga shteti shqiptar

Një nga problemet më të mprehta me të cilin u ndesh shteti shqiptar pas krijimit të tij ishte shpërngulja e shqiptarëve nga trojet e tyre etnike, të mbetura jashtë kufijve politikë të Shqipërisë. Çështja e qëndrimit të mbajtur nga shteti shqiptar ndaj shqiptarëve të larguar nga viset që ndodheshin nën administrimin e shtetit jugosllav (Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Sanxhaku), të cilët u vendosën në Shqipëri gjatë periudhës ndërmjet Dy Luftërave Botërore, nuk është trajtuar gjerësisht në historiografinë shqiptare. Për këtë arsye, në këtë artikull, do të përqipemi të hedhim një vështrim më të detajuar mbi mënyrën e trajtimit nga ana e shtetit shqiptar të shqiptarëve të shpërngulur nga Jugosllavia në Shqipëri gjatë viteve 1928-1929.

Nga viti 1912 e në vijim, autoritetet drejtuese serbo-malazeze dhe më vonë ato jugosllave synonin që përmes vrasjeve, dhunës dhe terrorit t'ua bënin të pamundur shqiptarëve jetesën në trojet e tyre etnike. Qarqet politike e shtetërore serbe dhe jugosllave, mendonin se zgjidhja e përhershme e çështjes shqiptare në Jugosllavi, mund të arrihej përmes ndryshimit të strukturës etnike të trojeve të banuara nga shqiptarët. Ato e konsideronin atë si çështje me rëndësi nacionale dhe ushtarake-strategjike.¹ Përmes procesit të shpërnguljes së shqiptarëve, Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene synonte me çdo mënyrë që të pakësonte numrin e shqiptarëve të Kosovës dhe viseve të tjera etnike. Për arsyet e lartpërmendura, Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene synonte vendosjen e popullsisë slllave dhe kryesisht asaj malazeze në fushat e Kosovës. Në këtë mënyrë, në Kosovë dhe viset e tjera etnike shqiptare u vendosën malazezë, serbë, kroatë ose rusë.²

¹ Izber Hoti, *Qëndrimi i diplomacisë italiane ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve (1930-1941)* (Prishtinë: [mungon shtëpia botuese], 1997), 107-108; Halim Purellku, "Shpërngulja e organizuar e shqiptarëve nga Jugosllavia në Turqi në vitet 30-të të shek. XX dhe qëndrimi i Mbretërisë Shqiptare", në *100 vjet Pavarësi*, Aktet e konferencës shkencore ndërkombëtare, vëll. II, përgatiti për botim akademik Beqir Meta (Tiranë: Botimet albanologjike, 2014), 110.

² Teki Selenica, *Shqipëria më 1927* (Tiranë: Tirana, 1928), CXXIV; Skender Lutfiu, "Shpërngulja e popullsisë shqiptare nga Mbretëria e Jugosllavisë dhe vendosja e tyre

Në këto rrethana, mijëra shqiptarë të këtyre viseve, të ndodhur në një gjendje të mjeruar, si dhe duke mos duruar më tej mjerimin dhe mizoritë e pandërprera jugosllave, u detyruan që të emigronin drejt Turqisë, ndërkohë që një pjesë e tyre u vendosën në territorin e shtetit amë.³ Krahas motiveve të lartpërmendura, një pjesë e shqiptarëve u detyruan të vinin në Shqipëri me qëllim që t'i shpëtonin asimilimit sllav dhe të ruanin identitetin e tyre kombëtar.⁴ Ndërkohë, gjatë viteve '20-'30 të shek. XX, disa familje shqiptare vendosën të dërgonin ilegalisht fëmijët e tyre në Shqipëri për t'u shkolluar, meqenëse shteti shqiptar ofronte bursa studimi për të rinjtë shqiptarë që vinin nga viset etnike shqiptare.⁵

Nga viti 1925 deri në vitin 1928, llogaritej që në Shqipëri u vendosën gjithsej 1 413 familje me 6 109 frymë të ardhura nga viset etnike shqiptare jashtë kufirit të shtetit shqiptar.⁶ Numri i shqiptarëve që shkuan në Turqi ishte shumë më i madh krahasuar me ata që u vendosën në Shqipëri. Kjo ndodhi për shkak se qeveritë jugosllave vlerësonin se interesi politik dhe strategjik i Jugosllavisë ishte që shqiptarët e shpërngulur të vendoseshin në Turqi. Ndërkohë që drejtuesit e shtetit jugosllav e kishin të qartë se, nëse shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera do të vendoseshin në Shqipëri, rikthimi i tyre në vendlindje do të ishte më i lehtë. Prandaj, autoritetet jugosllave zbatonin masa represive

në Monarkinë Shqiptare faktor determinues në raportet midis dy vendeve (1928-1939)". Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore *Shqipëria mes Dy Luftërave Botërore: Aspekte të politikës, të së drejtës, shoqërisë dhe kulturës shqiptare në vitet 1925-1939*, organizuar nga Instituti i Historisë (ASH) dhe Fakulteti Drejtësisë (UT), më 14 dhjetor 2023 (në proces botimi).

³ *Historia e Shqipërisë*, vëll II, botim i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave të RPSSH (Tiranë: 8 Nëntori, 1984), 45-48; Selenica, *Shqipëria më 1927*, CXXV; Marenglen Verli, *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë (1918-1941)* (Tiranë: Iliria, 1992), 71; Marenglen Verli, *Kosova në vështrim enciklopedik* (Tiranë: Toena, 1999); Jusuf Osmani, *Kolonizimi, reforma agrare dhe shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova 1918-1941, (Dokumente): Kolonizimi*, vëll.1 (Prishtinë: pa botues, 2016), 93.

⁴ Jani Sota, "Kontributi i mërgimtarëve kosovarë për historinë dhe kulturën e Myzeqesë (1912-1945)", *Kosova*, nr. 31-32 (2009): 305.

⁵ *Libri i Qarkoreve të Shtetit Shqiptar i Vitit 1922-1923*, nr. 4, botim i Ministrisë së Punëve të Mbrendshme (Tiranë: Tirana, 1923), "Ligji mbi bursa për 36 djelmë shqiptarë prej viseve të mbetuna jashta shtetit shqiptar", 403-404.

⁶ Selenica, *Shqipëria më 1927*, CXXIX.

ndaj shqiptarëve që këmbëngulnin të shpërnguleshin në Shqipëri ose nuk u jepnin pasaporta për të emigruar atje.⁷

Shqipëria u gjend para një situatë të vështirë dhe delikate në përballimin e fluksit të emigrantëve (muhaxhirëve)* shqiptarë të larguar nga dhuna dhe shtypja jugosllave. Kjo vështirësi shtohet edhe më shumë për shkak të gjendjes së vështirë financiare të shtetit shqiptar.

Për t'u ardhur në ndihmë shqiptarëve të shpërngulur nga vatrat e tyre, më 14 qershor 1923, Këshilli i Naltë dekretoi ligjin "Mbi të vendosurit e emigrantve dhe të bujqve në tokat e shtetit".⁸ Sipas këtij ligji, të gjithë të ardhurit, që ishin shqiptarë për nga raca e gjuha, të mbetur jashtë kufijve politikë të tij, të cilët ishin detyruar të linin vatrat e tyre nga dita e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë deri në momentin e publikimit të këtij ligji, konsideroheshin "imigrantë". Ata fitonin menjëherë të drejtën e shtetësisë shqiptare, si dhe u caktohej një vendbanim i përhershëm në territorin e shtetit shqiptar. Çdo familjeje "emigrante", qeveria shqiptare i jepte pa pagesë nga pasuria e shtetit, një gjysmë hektar tokë për ndërtimin e shtëpisë, si dhe dy hektarë të tjerë tokë për të siguruar jetesën. Ligji sanksiononte që tokat e mësipërme ishin të trashëgueshme, por jo të transferueshme. Ky legjislacion erdhi duke u përmirësuar gjatë viteve të mëvonshme. Të gjithë shqiptarët e shpërngulur (emigrantë) përjashtoheshin nga taksat dhe tatimet si: e dhjeta, e treta, vergjia e ndërtesave dhe taksa e pyjeve, por edhe nga çdo lloj detyrimi tjetër për një periudhë prej tre vjetësh, duke nisur që prej datës së vendosjes së tyre në Shqipëri.⁹

Gjatë viteve '20 të shek. XX, një ndihmë të madhe për shqiptarët e shpërngulur nga Kosova e viset e tjera dha kontesha Carnarvon, nëna e

⁷ Hoti, *Qëndrimi i diplomacisë italiane ndaj Shqipërisë*, 111-112; Purellku, "Shpërngulja e organizuar e shqiptarëve", 110.

* Për shqiptarët e viseve etnike shqiptare në Jugosllavi, të cilët u vendosën në Shqipëri, përdorëshin emërtime të ndryshme, si: emigrantë, imigrantë, muhaxhirë, shqiptarë iridentë.

⁸ *Libri i Qarkoreve i Vitit 1922-1923*, nr. 5, botim i Ministrisë së Punëve të Mbrendshme (Tiranë: Tirana, 1923), Pjesë e X-të – Ligje e rregullore, 267-268; Selenica, *Shqipëria më 1927*, CXXIII; Haxhi Shkoza, *Financat e Shqipërisë (1839-1934)* (Tiranë: Nikaj, 1935), 18-19; "Ligjë. Mi të vendosurit e Emigrantëve dhe të Bujqëve në Tokat e Shtetit", *Shqipëtar i Amerikës*, nr. 36, Korçë, 23 qershor 1923, 5.

⁹ *Po aty; Fletore Zyrtare*, nr. 50, Vjetit VIII, botim i Ministrisë së Punëve të Mbrendshme (Tiranë: 16 shtator 1929), 1, Dekretligjë "Mbi përjashtimin e emigrandëve nga e tretëta edhe për vjetin 1929", Tiranë, 22 gusht 1929.

deputetit të ndjerë britanik, kolonelit Aubrey Herbert. Gjatë kësaj periudhe, kontesha Carnarvon së bashku me zonjën Ruth V. Pennington u angazhuan në ndihmë të refugjatëve shqiptarë në Shqipëri.¹⁰

Në vitin 1925, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme u ngrit një drejtori e posaçme që merrej me procesin e instalimit të emigrantëve shqiptarë që vinin nga Kosova dhe Turqia. Në krye të kësaj drejtorie u emërua Teki Selenica. Në prefekturat dhe nënprefekturat e vendit u ngritën komisione të posaçme nën drejtimin e prefektëve dhe të nënprefektëve. Komisionet për vendosjen e emigrantëve vepronin sipas legjislacionit në fuqi, por edhe sipas udhëzimeve që dërgonte Ministria e Punëve të Brendshme. Këto komisione kishin për detyrë që të vërtetonin kombësinë e emigrantëve, të merreshin me vendosjen e emigrantëve shqiptarë në tokat shtetërore si dhe t'u lehtësonin atyre jetesën, duke i ndihmuar në ndërtimin e shtëpive, ofrimin e kujdesit shëndetësor por edhe në mbajtjen nën kontroll të veprimtarisë së tyre politike.¹¹

Të gjithë emigrantëve shqiptarë të shpërngulur nga Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene u jepej një shumë të hollash në formë huaje, e cila shërbente për blerjen e mjeteve të tyre bujqësore, sipas planifikimit që bënte Ministria e Punëve të Brendshme. Kjo hua do t'i kthehej shtetit shqiptar me këste, brenda një afati prej 10 vjetësh, ndërkohë që pagesa e huas nga shqiptarët e instaluar në Shqipëri, fillonte pas tre vjetësh nga data e instalimit të tyre. Grupet e emigrantëve të vendosur në tokat shtetërore që formonin katunde të veçanta, gëzonin të drejtën që të kishin vende të posaçme për kullotjen e bagëtive, prerjen e druve si dhe të varrezave.¹²

Gjatë vitit 1925, koloneli britanik W.F. Stirling, i cili mbante detyrën e këshilltarit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, hartoi një projekt për vendosjen e emigrantëve shqiptarë në Shqipëri. Sipas këtij projekti, qeveria shqiptare parashikonte që t'u jepte tokë emigrantëve shqiptarë, ndërsa Lidhjes së Kombeve do t'i kërkohej një hua për të ndihmuar ata, e cila do të përdorej për ndërtimin e shtëpive, blerjen e bagëtisë dhe të farës për mbjellje, si dhe për të mbuluar shpenzimet e

¹⁰ Joan Fultz Kontos, *Red Cross – Black Eagle: A Biography of Albania's American School* (Boulder, Co: East European Monographs, distributed by Columbia University Press) (New York: 1981), 81; Miranda Vickers, *Shqiptarët – Një histori moderne*, përkthyer nga Xhevdet Shehu (Tiranë: Bota Shqiptare, 2008), 206-207.

¹¹ Selenica, *Shqipëria më 1927*, CXXVI.

¹² *Po aty*, CXXVII.

jetesës së tyre deri në të korrat e reja.¹³ Më 14 dhjetor 1925, Mehdi Frashëri i kërkoi zyrtarisht Lidhjes së Kombeve që t'i jepte Shqipërisë një hua prej 120 000 sterlinash britanike për t'u ardhur në ndihmë emigrantëve. Qeveria shqiptare shpresonte se kërkesa e saj do të miratohej, përderisa Greqia kishte përfituar një hua në një shumë më të madhe për të njëjtin qëllim.¹⁴ Lidhja e Kombeve ua parashtrroi kërkesën e Shqipërisë ekspertëve të saj financiarë, por, me sa duket, puna e saj mbeti me kaq.

Shqipëria nuk arriti të merrte asnjë lloj mbështetjeje financiare nga jashtë, përveç ndihmës së ofruar nga kontesha Carnarvon dhe të fondit britanik "Save the Children Fund" që përfaqësohej nga H.W.H. Sams.¹⁵ Kontesha Carnarvon ndërtoi një fshat për refugjatët kosovarë në Kavajë – i cili mori emrin Herbert, në nderim të të birit të saj.¹⁶ Në këto rrethana, qeveria shqiptare u detyrua që t'i jepte një zgjidhje këtij problemi. Shteti shqiptar mori përsipër mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të ushqimit për emigrantët shqiptarë që kishin ardhur nga Jugosllavia, deri në vendet ku ishte planifikuar instalimi i tyre. Për shqiptarët e dëbuar nga viset e tyre etnike (në Jugosllavi dhe Greqi) gjatë viteve 1925-1928, të cilët kërkuan shpëtim në Shqipëri, shpenzimet e shtetit shqiptar arrinin në 452,961 franga ar. Ky fond financiar u përdor nga komisionet lokale, duke i dhënë çdo familjeje emigrante një shumë prej 300 frangash ari, për blerjen e veglave të punës, përfshirë një plug për punimin e tokës, i cili kushtonte 25 franga ari, si dhe për çdo muaj, qeveria shqiptare u jepte familjeve emigrante për ushqim nga 5 fr. ari për çdo anëtar të saj.¹⁷

Shteti shqiptar e kishte detyrim vendosjen e shqiptarëve të shpërngulur nga viset etnike shqiptare. Me këtë akt, ai u tregua i përgjegjshëm, duke demonstruar me prova se shqiptarët e mbetur jashtë kufijve të Shqipërisë nuk mund të liheshin në mëshirën e fatit. Po ashtu, drejtuesit e shtetit shqiptar dëshmuar se nuk e kishin harruar barrën e problemit të pazgjidhur kombëtar që rëndonte mbi të. Ata e kishin të

¹³ Joseph Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie*, përkthyer nga Kujtim Ymeri (Tiranë: Dituria, 2005), 369-370.

¹⁴ *The Near East and India*, London: January 14, 1926; *po aty*, February, 11, 1926; *po aty*, September 2, 1926; Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie*, 369.

¹⁵ Selenica, *Shqipëria më 1927*, CXXIX.

¹⁶ Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie*, 370; Selenica, *Shqipëria më 1927*, CXXVIII.

¹⁷ Selenica, *Shqipëria më 1927*, CXXVII.

qartë se Shqipëria do të humbiste autoritetin e vet në sytë e opinionit publik shqiptar dhe atij ndërkombëtar, nëse Tirana zyrtare nuk do të vepronte në këtë mënyrë. Për këtë arsye, nga njëra anë, shteti shqiptar ishte i detyruar që të deklaronte hapur se i pranonte të shpërngulurit shqiptarë, mirëpo nga ana tjetër, në praktikë, përpiquej me sa mundej që të dekurajonte si dhe të frenonte sa më tepër, shpërnguljen e shqiptarëve nga vatrat e tyre, me qëllim që kjo lëvizje masive të mos kthehej në një hemorragji të kësaj popullsie, e cila do të çonte në zbrazjen e viseve etnike shqiptare.¹⁸

Pranimi i shqiptarëve të arratisur nga Jugosllavia në Shqipëri, si dhe i shtetasve të tjerë jugosllavë, u përdor nga autoritetet e shtetit shqiptar edhe si një kundërpërgjigje ndaj mbështetjes që shteti jugosllav u jepte kundërshtarëve politikë të Ahmet Zogut, të arratisur në Jugosllavi. Prandaj, herë pas here, marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave u acaruan edhe për shkak të qëndrimit të mbajtur nga të dyja shtetet ndaj emigrantëve politikë që kalonin nga Jugosllavia në Shqipëri dhe anasjelltas. Kjo ishte një ndër çështjet, për të cilën, qeveria e Beogradit akuzonte qeverinë shqiptare për mungesë sinqeriteti në rregullimin e çështjes së emigracionit politik kosovar.¹⁹

Jugosllavia synonte që shqiptarët, të cilët kishin hyrë në territorin e Shqipërisë, të instaloheshin sa më larg kufirit shqiptaro-jugosllav.²⁰ Autoritetet e shtetit shqiptar u detyruan t'i vendosnin ata kryesisht në pjesën e Ultësirës Perëndimore të Shqipërisë, përkatësisht në rrethet e sotme të Fierit, Lushnjës, Kavajës, Durrësit, Beratit, Elbasanit, Krutës etj., të cilat për hir të së vërtetës ishin fusha pjellore, por shtriheshin në zona moçalore,²¹ ku jeta e shqiptarëve të shpërngulur fillimisht qe mjaft e vështirë. Ata u instaluan në këto rajone për dy arsye kryesore: *së pari*, shteti shqiptar nuk dispononte toka të lira në vende të tjera më të përshtatshme; *së dyti*, instalimi i tyre në viset e brendshme të shtetit

¹⁸ Hoti, *Qëndrimi i diplomacisë italiane ndaj Shqipërisë*, 109.

¹⁹ Lutfiu, "Shpërngulja e popullsisë shqiptare".

²⁰ Hoti, *Qëndrimi i diplomacisë italiane ndaj Shqipërisë*, 111-112; Purellku, "Shpërngulja e organizuar e shqiptarëve", 110.

²¹ Zamir Shtylla, "Shpërnguljet me dhunë të shqiptarëve nga Kosova dhe viset e tjera ndërmjet Dy Luftërave Botërore (1918-1941)", në *Çështja e Kosovës – Një problem historik dhe aktual*, përmbledhje e akteve të simpoziumit të mbajtur në Tiranë, më 15-16 prill 1993, organizuar nga Instituti i Historisë – Prishtinë dhe Instituti i Historisë – Tiranë (Tiranë: [pa shtëpi botuese], 1996), 178.

shqiptar synonte të evitonte incidentet kufitare, si dhe tensionimin e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë; *së treti*, prania e tyre në këto vise do të ndihmonte në forcimin e vitalitetit të banorëve të këtyre zonave; *së katërti*, vendosja e shqiptarëve në këto vise bëhej me qëllim që të shmangej ndonjë lëvizje politike e brendshme që mund të kthehej në një rrezik potencial për qeverinë në pushtet.²²

- - -

Si u trajtuan shqiptarët e Kosovës dhe viseve të tjera etnike të ardhur nga Jugosllavia në Shqipëri?

Në Arkivin Qendror të Shtetit të Republikës së Shqipërisë, në fondin e Ministrisë së Punëve të Brendshme – Zyra Sekrete, gjendet një koleksion dokumentesh që trajtojnë rastet e shqiptarëve të ardhur në Shqipëri gjatë viteve 1928-1929. Nga shqyrtimi i tyre, interes të posaçëm për ne paraqet mënyra e trajtimit nga shteti shqiptar i bashkatdhetarëve që arratiseshin nga territori i shtetit jugosllav dhe kalonin brenda kufirit të Shqipërisë; procedura që ndiqej nga ana e shtetit shqiptar për shqiptarët e shpërngulur që nga momenti i hyrjes së tyre në territorin e shtetit shqiptar deri në vendin e instalimit dhe të sistemimit të tyre. Krahas dokumenteve që përmbajnë këto dosje, pa dyshim që duhet të ketë dosje dhe dokumente të tjera, të cilat, pavarësisht përpjekjeve tona, nuk patëm mundësi t'i konsultojmë. Po ashtu, nuk përjashtohet mundësia që të ketë pasur edhe raste të tjera të shqiptarëve të larguar nga Jugosllavia, të cilët mund të jenë përpjekur që t'i shmangen regjistrimit nga ana e autoriteteve të shtetit shqiptar. Megjithatë, këto raste duhet të kenë qenë tepër të kufizuara, pasi çështja e kalimit të kufirit të shtetasve jugosllavë ishte një çështje sensitive për shtetin shqiptar. Prandaj, autoritetet shqiptare ishin mjaft të kujdesshme dhe të prera në këtë drejtim.

Nga vëzhgimi i dokumentacionit të këtyre dosjeve, konstatohet se gjatë viteve 1928-1929 numri i përgjithshëm i shtetasve jugosllavë që hynë në territorin të Shqipërisë, të cilët kaluan përmes filtrave të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Shqipërisë, ishte 61 persona. Nga këta, 49 veta ishin me kombësi shqiptare, ndërsa 12 të tjerë, ishin me

²² Hoti, *Qëndrimi i diplomacisë italiane ndaj Shqipërisë*, 109.

kombësi të huaj, kryesisht shtetas jugosllavë.²³ Ndërkohë, Skender Lutfiu shprehet se, sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, rezulton se gjatë vitit 1929, 55 kryefamiljarë ose 203 shqiptarë nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare, u shpërngulën në Shqipëri.²⁴

Nga numri i përgjithshëm i personave, që u dorëzuan apo u ndaluan nga autoritetet e shtetit shqiptar, 55 prej tyre ishin meshkuj dhe gjashtë ishin femra. Nga këto të fundit, katër femra ishin me kombësi shqiptare, ndërsa dy të tjera ishin me kombësi serbe. Ndërkaq, nga shifra e përgjithshme e lartpërmendur, rezulton që 17 prej tyre ishin fëmijë shqiptarë, prej të cilëve, 14 ishin djem dhe tri vajza. Në fakt, fëmijët ishin arratisur nga territori i shtetit jugosllav së bashku me prindërit apo me të afërm të tyre.²⁵ Nga dokumentacioni zyrtar i Ministrisë së Punëve të Brendshme, vihet re se arratisjet e shqiptarëve nga Jugosllavia ndodhnin kryesisht gjatë stinës së pranverës dhe të verës.

Lidhur me numrin e shqiptarëve si dhe të huajve që mbanin shtetësi jugosllave, të arratisur përmes sektorëve kufitarë të prefekturave të shtetit shqiptar, situata paraqitet e tillë: prefektura e Kosovës raportonte se gjatë viteve 1928-1929 në territorin e saj kishin hyrë 48 veta, shumica e të cilëve ishin shqiptarë të Kosovës. Nga prefektura e Shkodrës ishte regjistruar një rast; nga prefektura e Korçës dy raste; nga Komiseria e Policisë së Qendrës së Tiranës raportohej për dy persona. Ndërkohë, për personat e tjerë në dokumentacionin zyrtar nuk specifikohet në mënyrë të qartë nga cila prefekturë kishin kaluar kufirin. Nga komunikimi zyrtar ndërmjet institucioneve shqiptare, lihet të kuptohet se përmes sektorëve të kufirit të prefekturës së Kosovës kishin kaluar edhe persona të tjerë, të cilët më vonë ishin ndaluar në brendësi të vendit.²⁶ Nga shqyrtimi i të dhënave që prefekturat i përcillnin Zyrës Sekrete të Ministrisë së Punëve

²³ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F) 152, Viti (më tej: V) 1928, Dosja (më tej: D) 64, fl. 201. Telegram shifër nr. 3/68 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, Novruz Taçi, për Zyrën Sekrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme (më tej: MPB), Kukës, 8 maj 1928; *po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64/a, fl. 369. Kopje e shkresës [pa numër] së konsullit shqiptar në Korfuz, M. Vrioni, për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Korfuz, 26 qershor 1928.

²⁴ Lutfiu, "Shpërngulja e popullsisë shqiptare".

²⁵ *AQSH*, F. 152, V. 1928, D. 64, fl. 201. Telegram shifër nr. 3/68 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi, për Zyrën Sekrete të MPB-së, Kukës, 8 maj 1928.

²⁶ *Po aty*.

të Brendshme rezulton se numri më i lartë i të arratisurve nga Jugosllavia me origjinë shqiptare apo sllave ndodhte në sektorët kufitarë të prefekturës së Kosovës.

Nga shqyrtimi me kujdes i korrespondencës së drejtuesve të prefekturave, të trupës së xhandarmërisë kufitare dhe të ushtrisë shqiptare me Zyrën Sekrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe anasjelltas, rezulton se për 46 veta që kishin hyrë në territorin e shtetit shqiptar nuk pasqyrohej qartë nëse ata kishin me vete ndonjë lloj dokument identifikimi. Për pesë raste të tjera, raportohej se kishin hyrë brenda shtetit shqiptar me leje ose që zotëronin një pasaportë me vizë të lëshuar nga autoritetet përkatëse (pa specifikuar se për cilat autoritete bëhej fjalë). Vetëm për një rast, përshkruhej qartë se personi në fjalë ishte arratisur dhe më tej ishte kapur pa pasaportë apo dokumente të tjera identifikuese. Për pesë veta të tjerë, prefekturat i raportnin Ministrisë së Punëve të Brendshme se kishin dalë nga Jugosllavia në Shqipëri, pa leje kalimi, ndërsa për tri raste të tjera, thuhej se, nuk kishin vizuar pasaportën në legatën shqiptare në Beograd.

Për sa u përket vendeve të origjinës së shqiptarëve që kishin hyrë në Shqipëri, rezulton se gjatë kësaj periudhe nga Peja ishin arratisur 15 veta, mes tyre edhe dy serbë dhe një malazez. Prandaj, rrethi i Pejës shënonte numrin më të lartë të arratisjeve në harkun kohor të viteve 1928-1929.²⁷ Nga Prizreni ishin arratisur 12 shqiptarë,²⁸ duke zënë vendin e dytë; nga Gjakova kishte pesë të arratisur, nga të cilët katër ishin shqiptarë,²⁹ ndërsa i pesti ishte shtetas jugosllav me origjinë serbe; nga Lipjani ishin arratisur katër shqiptarë;³⁰ Shkupi kishte tre shqiptarë të arratisur;³¹ nga

²⁷ *Po aty*, fl. 267. Telegram shifër nr. 3/91 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Kukës, 5 qershor 1928; *po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64/a, fl. 322. Shkresë nr. 32/93 e komandantit të Përgjithshëm të Xhandarmërisë, Kasem Sejдини, për MPB-në, Tiranë, 27 qershor 1928.

²⁸ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64, fl. 214. Telegram shifër nr. 3/72 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Kukës, 15 maj 1928; *po aty*, fl. 209. Telegram i MPB-së për Ministrinë e Punëve të Jashtme (më tej: MPJ) të Shqipërisë, Tiranë, 11 maj 1928; *po aty*, fl. 251. Telegram shifër nr. 3/84 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Kukës, 28 maj 1928.

²⁹ *Po aty*, fl. 255. Telegram shifër nr. 3/86 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Kukës, 31 maj 1928.

³⁰ *Po aty*, fl. 259. Telegram shifër nr. 3/87 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Kukës, 2 qershor 1928.

rrethet e Llapit, Prishtinës, Drenicës dhe Qyprilisë secili prej tyre kishte nga dy shqiptarë të arratisur; ndërsa Rahoveci dhe Manastiri kishte secili nga një shqiptar të arratisur. Ndërkohë, në dokumentacionin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Shqipërisë rezulton se ishin edhe dy persona të tjerë të arratisur, të regjistruar si shqiptarë të Kosovës, për të cilët nuk jepej me saktësi vendi i tyre i origjinës.³²

Nga shqyrtimi i të dhënave të mësipërme, vihet re se numri më i madh i arratisjeve u përkiste shqiptarëve me origjinë nga rrethet e pjesës perëndimore të Kosovës (Rrafshit të Dukagjinit) që ndodheshin pranë kufirit me Shqipërinë. Për sa i përket përbërjes kombëtare të të huajve që kishin kaluar në mënyrë të paligjshme kufirin mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë, konstatohet se nga shtetasit jugosllavë kishte tre serbë; tre maqedonas si dhe një tjetër i cilësuar bullgar, por që mbante shtetësi jugosllave; një boshnjak që i përkiste besimit mysliman dhe ishte me origjinë nga Banja Luka; një malazez; një hungarez; një austriak, si dhe dy të tjerë që cilësoheshin si shtetas jugosllavë, por pa përcaktuar identitetin e tyre kombëtar.³³

Lidhur me arsyet e paraqitura nga personat që hynë në Shqipëri nga Jugosllavia, rezulton se shumica e tyre ishin shtetas jugosllavë që u larguan për t'i shpëtuar persekutimit dhe mundimeve nga ana e autoriteteve serbe / jugosllave.³⁴ Grupi i të larguarve që shpreheshin se ishin persekutuar nga autoritetet jugosllave arrinte në 18 veta, ndër të cilët 17 ishin shqiptarë etnikë dhe një shtetas jugosllav me origjinë bullgare. Ndërkohë, për 18 të arratisur të tjerë që kishin hyrë në Shqipëri, 11 ishin shqiptarë etnikë dhe shtatë prej tyre ishin shtetas jugosllavë ose

³¹ *Po aty*, fl. 217. Telegram shifër nr. 3/74 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Kukës, 16 maj 1928.

³² *Po aty*, fl. 230. Shkresë nr. 1104/III e prefektit të Beratit, Ismet Kryeziu, për Drejtorinë e Korrespondencës në MPB, Berat, 14 maj 1928.

³³ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64/a, fl. 369. Kopje e shkresës [pa numër] e konsullit shqiptar në Korfuz, M. Vrioni, për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Korfuz, 26 qershor 1928.

³⁴ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64, fl. 209. Telegram i MPB-së për MPJ-në, Tiranë, 11 maj 1928; *po aty*, fl. 214. Telegram shifër nr. 3/72 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, Novruz Taçi d.v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Tiranë, 15 maj 1928; *po aty*, fl. 251. Telegram shifër nr. 3/84 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për MPB-në, Kukës, 28 maj 1928; *po aty*, fl. 259. Telegram shifër nr. 3/87 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Tiranë, 2 qershor 1928.

të huaj, por që në dokumente nuk pasqyrohej arsyeja e hyrjes së tyre në territorin e Shqipërisë.³⁵

Ndërkaq, dhjetë shqiptarë të tjerë ishin arratisur nga trojet e tyre etnike për arsye emigrimi, me qëllim që të bashkoheshin me pjesëtarë të tjerë të familjes që kishin ardhur më herët në Shqipëri apo që ndodheshin atje për të siguruar jetesën.³⁶ Nga shifrat e përpunuara nga Ministria e Punëve të Brendshme, rezulton se dhjetë shtetas shqiptarë, të dënuar për vrasje në burgjet jugosllave, kishin arritur të arratiseshin dhe të kalonin kufirin shqiptaro-jugosllav.³⁷ Ndërkohë, dy shtetas jugosllavë me origjinë sllave deklarorin se arsyeja e arratisjes së tyre ishte dëshira për të jetuar në Shqipëri, duke shprehur gjithashtu ndjenja filoshqiptare.

Çfarë qëndrimi mbajtën autoritetet e shtetit shqiptar ndaj shqiptarëve të larguar nga Jugosllavia në Shqipëri?

Nga dokumentacioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme rezulton se pothuajse për të gjithë shqiptarët të cilët u arratisën nga Jugosllavia dhe kërkuan strehim në Shqipëri, ose që u përpoqën të shfrytëzonin territorin e këtij vendi për t'u larguar në drejtim të vendeve të tjera, autoritetet e shtetit shqiptar nuk i kthyen mbrapsht dhe nuk ua dorëzuan shtetit jugosllav. Pavarësisht gjendjes së vështirë ekonomike, sociale dhe politike që kalonte Shqipëria, shteti shqiptar vendosi që shqiptarët e larguar nga Jugosllavia t'i mbante dhe t'i strehonte në territoret e tij.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se autoritetet shqiptare nuk kryen hetime dhe verifikime për shqiptarët që hynin në territorin e Shqipërisë. Nëse gjatë periudhës së qëndrimit të shqiptarëve të ardhur nga Jugosllavia në Shqipëri konstatohej se elementë të caktuar zhvillonin

³⁵ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64/a, fl. 369. Kopje e shkresës [pa numër] e konsullit shqiptar M. Vrioni në Korfuz për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Korfuz, 26 qershor 1928.

³⁶ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64, fl. 242. Telegram shifër nr. 3/82 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Kukës, 23 maj 1928.

³⁷ *Po aty*, fl. 255. Telegram shifër nr. 3/86 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Kukës, 31 maj 1928; *po aty*, fl. 204. Telegram shifër nr. 3/69 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi, për MPB-në, Kukës, 9 maj 1928; *po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64/a, fl. 345. Telegram shifër nr. 3/113 i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi, për Zyrën Sekrete të MPB-së, Kukës, 9 korrik 1928.

veprimtari kundër interesave të shtetit dhe drejtuesve të tij, autoritetet shqiptare i mbanin ata nën survejim ose, në rastet më ekstreme, i pajisnin me lejekalimi dhe u kërkoheshin të largoheshin drejt Greqisë apo vendeve të tjera që dëshironin, por pa i dorëzuar në duart e autoriteteve jugosllave. Duhet theksuar se për shtetasit e huaj me kombësi joshqiptare nuk ndiqej e njëjta politikë. Nëse autoritetet e shtetit shqiptar kishin edhe dyshimin më të vogël se këta të huaj të ardhur nga Jugosllavia zhvillonin veprimtari me karakter politik apo agjenturor, ata dëboheshin menjëherë nga Shqipëria, duke i nxjerrë kryesisht përmes territorit të krahinarisë së Sarandës, në drejtim të Korfuzit të Greqisë.³⁸

I vetmi rast kur Ministria e Punëve të Brendshme iu shmang praktikës së saj të mësipërme lidhej me një shqiptar nga Prizreni,^{*} për të cilin u vendos që të dëbohej nga territori i Shqipërisë.³⁹ Pas hyrjes së tij në Shqipëri dhe vendosjes së familjes së tij në nënprefekturën e Pukës, Zyra Sekrete e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Shqipërisë kërkoi që ky person të paraqitej pranë kësaj ministrie.⁴⁰ Pas këtij takimi, me sa duket, ky shqiptar i Kosovës u tregua i gatshëm që të bashkëpunonte me Zyrën Sekrete, prandaj Ministria e Brendshme kërkoi që ai së bashku me familjen e tij të zhvendosej nga qarku i nënprefekturës së Pukës dhe të vendosej në qytetin e Shkodrës.⁴¹ Zyra Sekrete mori përsipër mbulimin e

³⁸ *Po aty*, fl. 248. Telegram i ministrit të Punëve të Brendshme, K. Kotta d.v., për prefekturën e Vlorës dhe nënprefekturën e Delvinës, Tiranë, 26 maj 1928; *po aty*, fl. 276. Shkresë nr. 87/II Res. e nënprefekturës së Delvinës për prefekturën e Gjirokastrës dhe për dijeni Zyrës Sekrete të MPB-së, Delvinë, 1 qershor 1928; *po aty*, fl. 264. Telegram shifër i MPB-së për prefekturën e Gjirokastrës, Tiranë, 4 qershor 1928; *po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64/a, fl. 308. Telegram nr. 118/7 Res. i prefekturës së Gjirokastrës për Zyrën Sekrete të MPB-së, Gjirokastrë, 23 qershor 1928.

* Shqiptari me inicialet Q. O., me origjinë nga Prizreni, kishte hyrë në Shqipëri së bashku me familjen e tij dhe fillimisht ishte strehuar në katundin Shikaj të Vaspasit. Atje, ai vendosi kontakte me krahinarin e Vaspasit për të zhvilluar veprimtari zbulimi në favor të shtetit shqiptar, por në fakt rezultoi e kundërta.

³⁹ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64/1, fl. 636. Telegram shifër nr. 169/8 i Zyrës Sekrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme për prefekturën e Shkodrës, Tiranë, 21 maj 1928.

⁴⁰ *Po aty*, fl. 624.1. Telegram shifër nr. 169 i MPB-së për nënprefekturën e Pukës, Tiranë, 5 mars 1928; *po aty*, fl. 625. Shkresë nr. 19/I Res. e nënprefektit të Pukës për Zyrën Sekrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Pukë, 9 mars 1928.

⁴¹ *Po aty*, fl. 626. Shkresë nr. 169/I e Zyrës Sekrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme për nënprefekturën e Pukës, Tiranë, 14 mars 1928; *po aty*, fl. 628. Telegram nr. 19/II Res. i nënprefektit të Pukës, S. Gostivari, për Zyrën Sekrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Pukë, 6 prill 1928.

shpenzimeve të kësaj familjeje, si dhe nxiti autoritetet vendore që ta ndihmonin atë për gjetjen e një banese në qytetin e Shkodrës. Më 6 prill 1928, Zyra Sekrete i kërkonte prefekturës së Shkodrës që, sapo familja e personit në fjalë të vendosej në Shkodër, t'i çelej një kredi financiare, me të cilën do t'i sigurohej jetesa familjes së tij, si dhe t'i jepej një rrogë mujore prej 100 fr. ari nga fondet për veprimtari sekrete që dispononte kjo ministri.⁴²

Brenda disa ditëve, Zyra Sekrete e Ministrisë së Brendshme i dërgoi prefekturës së Shkodrës një shumë prej 150 fr. ari, e cila duhej t'i dorëzohej këtij personi, kundrejt nënshkrimit të dëftesës së marrjes në dorëzim të të hollave.⁴³ Pas disa ditëve nga dërgesa e parë në të holla, ministri i Punëve të Brendshme, Abdurrahman Dibra, njoftonte prefekturën e Shkodrës se po i dërgonte asaj një shumë tjetër prej 100 fr. ari, e cila duhej t'i dorëzohej të njëjtit person kundrejt një dëftese të rregullt.⁴⁴

Nuk kaloi shumë kohë dhe përpjekjet e Zyrës Sekrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Shqipërisë për t'u mbështetur në shërbimet e vyera të këtij personi dështuan. Më 21 maj 1928, Zyra Sekrete urdhëroi prefekturën e Shkodrës që ky person së bashku me familjen e tij, të shoqëruar nga forcat e xhandarmërisë, të dëboheshin (ekspulsoheshin) menjëherë nga territori i Shqipërisë për në Jugosllavi.⁴⁵ Me sa duket, shkaku i dëbimit të tij ishte fakti se ai u përpoq të luante një lojë të dyfishtë me shërbimet sekrete të të dyja shteteve. Ndryshe nga vendimi i mëparshëm, autoritetet e shtetit shqiptar, më në fund, vendosën që ky person, së bashku me familjen e tij, të largohej drejt Turqisë. Më 3 qershor 1928, prefekti i Shkodrës, Siri Leskoviku, njoftoi Zyrën Sekrete se gjatë asaj dite ishte realizuar dëbimi i Q. O. përmes skelës së Shëngjinit.⁴⁶

⁴² *Po aty*, fl. 627. Shkresë nr. 169/II e Zyrës Sekrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme për prefekturën e Shkodrës, Tiranë, 7 prill 1928.

⁴³ *Po aty*, fl. 630. Shkresë nr. 169/IV e Zyrës Sekrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme për prefekturën e Shkodrës, Tiranë, 17 prill 1928.

⁴⁴ *Po aty*, fl. 634. Shkresë nr. 169/6 e ministrit të Punëve të Brendshme, Abdurrahman Dibra, për prefekturën e Shkodrës, Tiranë, 26 prill 1928.

⁴⁵ *Po aty*, fl. 636. Telegram shifër nr. 169/8 i Zyrës Sekrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme për prefekturën e Shkodrës, Tiranë, 21 maj 1928.

⁴⁶ *Po aty*, fl. 638. Telegram shifër nr. 107/VI Res. i prefektit të Shkodrës, Siri Leskoviku, për Zyrën Sekrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Shkodër, 3 qershor 1928.

Cila ishte procedura e shqyrtimit të kërkesave të të arratisurve që hynin në Shqipëri?

Për rastet e shqiptarëve që hynin në Shqipëri me familje, të afërm apo miq dhe kërkonin të bashkoheshin me pjesëtarë të tjerë të familjes që ishin instaluar më herët në Shqipëri, procedura parashikonte kryerjen e një hetimi të shpejtë nga drejtuesit e prefekturave, kontaktimin e personave pritës në Shqipëri, pranë të cilëve, të ardhurit kishin shprehur dëshirën për t'u vendosur, si dhe mbledhjen e të dhënave për ta në rrugë të ndryshme. Personat pritës pyeteshin hollësisht mbi lidhjet farefisnore me të ardhurit, rrethanat e njohjes mes tyre, si dhe për sjelljen (qëndrimin politik) dhe moralin e tyre.⁴⁷

Në rast se personi pritës deklaronte se personat që vinin nga viset etnike në Jugosllavi i njihte dhe se garantonte që ata kishin sjellje dhe moral të mirë, Zyra Sekrete e Ministrisë së Punëve të Brendshme miratonte kërkesën e të ardhurve për instalim pranë të afërmeve të tyre në Shqipëri.⁴⁸ Nëse të ardhurit nga Jugosllavia shpreheshin se nuk kishin të afërm apo njerëz të njohur në Shqipëri, ata dërgoheshin për t'u vendosur në vendet e planifikuara dhe të përcaktuara nga shteti shqiptar, kryesisht në rajonet e Ultësirës Perëndimore të Shqipërisë.⁴⁹

Për rastet kur personi pritës deklaronte se nuk i njihte të ardhurit dhe se nuk kishte kurrfarë lidhjeje gjaku apo njohjeje miqësore me ta, si edhe kur autoritetet shqiptare kishin dyshime mbi identitetin e tyre, Ministria e Punëve të Brendshme zakonisht u kërkonte prefekturave – kryesisht asaj të Kosovës – që këta të ardhur të mos lejoheshin të niseshin

⁴⁷ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64, fl. 251. Telegram shifër nr. 3/84 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për MPB-në, Tiranë, 28 maj 1928; *po aty*, fl. 274. Telegram i MPB-së për prefekturën e Tiranës, Tiranë, 6 qershor 1928; *po aty*, fl. 275. Telegram i MPB-së për prefekturën e Durrësit, Tiranë, 6 qershor 1928; *po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64/a, fl. 357. Telegram shifër nr. 36/130 i Zyrës Sekrete të MPB-së për prefekturën e Vlorës, Tiranë, 16 korrik 1928.

⁴⁸ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64, fl. 225. Telegram shifër i MPB-së për prefekturën e Kosovës, Tiranë, 18 maj 1928; *po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64/a, fl. 365. Telegram shifër nr. 46/ Res. i nënprefektit të Fierit, R. Kikia d.v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Fier, 19 korrik 1928.

⁴⁹ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64, fl. 245. Telegram i ministrit të Punëve të Brendshme, K. Kotta d.v., për prefekturën e Kosovës dhe prefekturën e Shkodrës, Tiranë, 24 maj 1928.

drejt vendit ku kishin kërkuar që të vendoseshin.⁵⁰ Të ardhurit urdhëroheshin që të qëndronin në atë qark prefekturë derisa të mblidhej informacioni i plotë dhe të sqaroheshin motivet dhe rrethanat e ardhjes së tyre në Shqipëri. Në disa raste, Zyra Sekrete porosiste prefekturat që, nëse këta persona nuk pranonin t'u bindeshin urdhrave të autoriteteve shqiptare, të mos përjashtohesh mundësia e rikthimit të tyre në Jugosllavi.⁵¹

Në rastet kur në Shqipëri hynte një grup i madh shqiptarësh dhe nga hetimet e kryera rezultonte se, pritësit i njihnin disa prej tyre, ndërkohë që për të tjerët, ata nuk kishin njohje ose nuk u kujtohej lidhja e tyre, Ministria e Punëve të Brendshme kërkonte që personat për të cilët nuk kishte të dhëna, duhej të ndaheshin nga grupi dhe të prisnin deri në një urdhër të dytë. Ndërkaq, për shqiptarët për të cilët kishte të dhëna të besueshme, autoritetet lejonin që ata të shkonin në destinacionin e kërkuar.⁵²

Për rastet e shqiptarëve që kishin kryer vrasje dhe vinin në Shqipëri të shoqëruar nga pjesëtarë të familjes së tyre të gjinisë femërore, autoritetet shqiptare mbanin një qëndrim relativisht më të butë. Sapo shihej se këta persona vinin të shoqëruar nga gra dhe nuk kishin ndonjë qëllim politik negativ ndaj shtetit dhe drejtuesve të tij, autoritetet shqiptare kërkonin që ata të vendoseshin në vendet ku kishin shprehur dëshirën për të jetuar.⁵³

Në rrjedhën e arratisjeve të detyruara të shqiptarëve nga Jugosllavia, pati disa raste kur në territorin e shtetit shqiptar hynin edhe gra me fëmijë apo të rinj shqiptarë në nevojë.⁵⁴ Për këto raste, pas një

⁵⁰ *Po aty*, fl. 229. Telegram shifër i MPB-së për prefekturën e Kosovës, Tiranë, 19 maj 1928.

⁵¹ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64/a, fl. 317. Telegram shifër i Zyrës Sekrete të MPB-së për prefekturën e Kosovës, Tiranë, 26 qershor 1928.

⁵² *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64, fl. 279. Telegram shifër i MPB-së për prefekturën e Kosovës, Tiranë, 7 qershor 1928.

⁵³ *Po aty*, fl. 216. Telegram shifër i ministrit të Punëve të Brendshme, K. Kotta d.v., për prefekturën e Kosovës dhe prefekturën e Shkodrës, Tiranë, 17 maj 1928; *po aty*, fl. 254. Telegram shifër i ministrit të Punëve të Brendshme, K. Kotta d.v., për prefekturën e Kosovës dhe Drejtorinë e Emigracionit, Tiranë, 1 qershor 1928.

⁵⁴ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64/a, fl. 323. Telegram shifër nr. 3/105 Res. i prefektit të Kosovës, N. Taçi, për Zyrën Sekrete të MPB-së, Kukës, 28 qershor 1928; *po aty*, fl. 344. Telegram shifër nr. 3/111 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi, për Zyrën Sekrete të MPB-së, Kukës, 8 korrik 1928.

verifikimi të shpejtë, autoritetet shqiptare vendosnin që ata të dërgoheshin menjëherë në vendin që kishin kërkuar, ose në vendin e instalimit të caktuar nga shteti shqiptar.⁵⁵ Kështu ndodhi në rastin e një nëne shqiptare nga Peja*, e cila kishte kaluar kufirin së bashku me fëmijët e saj dhe ndodhej në një gjendje të mjeruar. Ministria e Punëve të Brendshme u kërkoi drejtuesve të prefekturës së Kosovës që të mbulonin shpenzimet e nevojave të saj familjare gjatë kohës së qëndrimit në atë prefekturë, si dhe njëherësh i kërkoi me urgjencë prefektit të Durrësit që të njoftohej sa më parë kunati i saj, emigrant i vendosur në Shënvllash të Durrësit, që të nisej menjëherë për në Tropojë për të marrë kunatën së bashku me fëmijët e saj.⁵⁶

Gjatë kësaj periudhe, autoritetet jugosllave shpeshherë i nxisnin shqiptarët e viseve etnike në Jugosllavi që të shkonin në Shqipëri, duke i mashtruar me premtimin se, në një fazë të mëvonshme, do të mund të riktheheshin për të shitur pasurinë e patundshme dhe bagëtinë e tyre. Në të vërtetë, përmes kësaj taktike, autoritetet e shtetit jugosllav synonin të “hiqnin qafe” shqiptarët, pasi në rastin e dy personave me banim në rrethin e Prizrenit, drejtuesit e prefekturës së Prizrenit në dokumentet që u lëshuan atyre, kishin bërë shënimin “vizë vetëm për një kalim” në Shqipëri. Në këto rrethana, drejtuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme iu drejtuan Ministrisë së Punëve të Jashtme që t’i paraqitej një ankesë qeverisë jugosllave për këto lloj rastesh.⁵⁷

Shteti shqiptar e kishte më të lehtë instalimin dhe sistemimin e shqiptarëve të larguar nga Jugosllavia, të cilët zotëronin një profesion ose zanat,⁵⁸ pasi autoritetet shqiptare nuk do t’u duhej të shqetësoheshin për gjetjen e tokës, si dhe për mbulimin e një pjese të shpenzimeve të tyre derisa ata të merrnin veten nga ana ekonomike. Prandaj, për këto raste, Ministria e Punëve të Brendshme u kërkonte prefekturave që ky kontingjent shqiptarësh të lejohej të vendosej në ndonjë qytet të madh

⁵⁵ *Po aty*, fl. 328. Telegram shifër i MPB-së për prefekturën e Kosovës, Tiranë, 2 korrik 1928.

* Kjo nënë shqiptare quhej Oze Ademi.

⁵⁶ *Po aty*, fl. 343. Telegram shifër nr. 36/122 i Zyrës Sekrete të MPB-së për prefekturën e Durrësit, Tiranë, 9 korrik 1928.

⁵⁷ *AQSH*, F. 152, V. 1928, D. 64, fl. 209. Telegram i Ministrisë së Punëve të Brendshme për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Tiranë, 11 maj 1928.

⁵⁸ *Po aty*, fl. 217. Telegram shifër nr. 3/74 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për MPB-në, Kukës, 16 maj 1928.

zejtar e tregtar si Shkodra. Megjithatë, Zyra Sekrete i porosiste drejtuesit e prefekturave që ata duhej të mbaheshin nën survejim për një periudhë kohe.⁵⁹

Qëndrimi i prefekturave ndaj të arratisurve nga Jugosllavia për në Shqipëri

Nga shqyrtimi i dokumentacionit zyrtar, që realizohej ndërmjet prefekturave dhe Zyrës Sekrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme në Tiranë, rezultonte se për 11 raste të të arratisurve nga Jugosllavia në Shqipëri, prefektët i kërkonin kësaj ministrie që t'u dërgonte urdhrin mbi mënyrën e veprimit si dhe vendqëndrimin e këtyre personave.⁶⁰ Madje, në dy raste, ato ishin kërkesa të përsëritura. Ndërkohë, për pesë raste të tjera, pritej urdhri i Ministrisë së Punëve të Brendshme vetëm për vendqëndrimin e tyre.⁶¹

Në gjashtë situata të tjera, kur shumica e individëve të marrë në pyetje konsideroheshin njerëz të dyshimtë, prefektët i kërkonin kësaj ministrie mënyrën e veprimit ndaj tyre.⁶² Ndërsa, në pesë raste të tjera, autoritetet vendore – kryesisht drejtuesit e xhandarmërisë dhe të ushtrisë shqiptare – në komunikimin e tyre zyrtar me Ministrinë e Punëve të

⁵⁹ *Po aty*, fl. 216. Telegram shifër i ministrit të Punëve të Brendshme, K. Kotta d.v., për prefekturën e Kosovës dhe prefekturën e Shkodrës, Tiranë, 17 maj 1928; *po aty*, fl. 245. Telegram i ministrit të Punëve të Brendshme, K. Kotta d.v., për prefekturën e Kosovës dhe prefekturën e Shkodrës, Tiranë, 24 maj 1928.

⁶⁰ *Po aty*, fl. 251. Telegram shifër nr. 3/84 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për MPB-në, Tiranë, 28 maj 1928; *po aty*, fl. 255. Telegram shifër nr. 3/86 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Tiranë, 31 maj 1928; *po aty*, fl. 259. Telegram shifër nr. 3/87 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Tiranë, 2 qershor 1928.

⁶¹ *Po aty*, fl. 210, Telegram shifër nr. 3/71 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për MPB-në, Tiranë, 14 maj 1928.

⁶² *Po aty*, fl. 222. Telegram shifër nr. 3/75 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për MPB-në, Tiranë, 17 maj 1928; *po aty*, fl. 242. Telegram shifër nr. 3/82 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Tiranë, 23 maj 1928; *po aty*, fl. 267. Telegram shifër nr. 3/91 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Tiranë, 5 qershor 1928; *po aty*, fl. 269. Telegram shifër nr. 3/92 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Tiranë, 5 qershor 1928; *po aty*, fl. 283. Telegram shifër nr. 50 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për MPB-në, Tiranë, 9 qershor 1928.

Brendshme nuk shpreheshin qartë se çfarë kërkonin prej autoriteteve eprore lidhur me personat që kishin hyrë brenda kufirit të shtetit shqiptar.

Mes rreshtave të shkresave e telegrameve që i paraqiteshin dikasterit epror për disa raste emigrantësh, vihet re se prefektët shfaqnin një prirje qartësisht të anshme, duke demonstruar një qëndrim dashamirës ose jodashamirës ndaj tyre. Me sa duket, përmes shkresave zyrtare, ata përpiqeshin të orientonin drejtuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme mbi qëndrimin përfundimtar që duhej të merrej për këto raste. Prandaj, për rastet kur prefektët synonin të përcillnin një mendim pozitiv tek institucioni epror i tyre, ata përdornin këto mënyra të shprehuri: “Pas hetimeve të kryera, rezulton se i përmenduri ka sjellje të mira, prandaj nuk shihet ndonjë pengim nga qëndrimi i tij në Shkodër. Presim urdhnin e Ministrisë së Punëve të Mbrendshme për mënyrën e veprimit”;⁶³ “Kjo prefekturë nuk sheh ndonjë ndalim, nëse nuk ka pengesa të tjera. Ju lutem, na njoftoni që t’i jepet leja e kërkuar”;⁶⁴ “Lutemi të na autorizohet shpërndarja e tyne në qendra të ndryshme, që kanë për t’u parë të arsyeshme”;⁶⁵ “Na autorizoni t’i japim leje-kalimi për të shkuar në Turqi”.⁶⁶

Për rastet kur drejtuesit e prefekturave dëshironin që t’i përcillej një mendim orientues negativ Zyrës Sekrete të kësaj ministrie, ata paraqisnin këto mënyra të shprehuri: “Autorizoni internimin e tij në fortesën e Gjinokastrës ose ekspulsimin jasht shtetit”;⁶⁷ “Mbasi i përmenduni dyshohet se do të jet ndonjë bashkë-punues me t’aratisunit politik, ju dorëzue autoriteteve të vendit për ndjekje ligjore...”;⁶⁸ “I përmenduri të dërgohet në një vend, ku të mos ketë kufi. Telegrafoni pëlqimin e asaj

⁶³ *Po aty*, fl. 242. Telegram shifër nr. 3/82 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Tiranë, 23 maj 1928.

⁶⁴ *Po aty*, fl. 230. Shkresë nr. 1104/III e prefektit të prefekturës së Beratit, Ismet Kryeziu për MPB-në, Tiranë, Berat, 14 maj 1928.

⁶⁵ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64/a, fl. 303. Shkresë nr. 76 Res. e prefektit të Beratit, I. Kryeziu, për Drejtorinë e Korrespondencës së MPB-së, Berat, 16 qershor 1928.

⁶⁶ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64/1, fl. 684. Telegram i prefektit të Gjirokastrës, Zef Kadarja, për Ministrinë e Punëve të Brendshme, Gjirokastrë, 21 janar 1929.

⁶⁷ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64, fl. 240. Telegram shifër nr. 124 Res. i prefektit të Korçës, Jella d.v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Korçë, 22 maj 1928.

⁶⁸ *Po aty*, fl. 250. Shkresë nr. 51 Res. e zëvendëskomandantit të Baonit 2 Kufizuer, Kapiten I Mandiqi d.v., për Komandën P. F. Armate, Korçë, 22 maj 1928.

Ministrije”,⁶⁹ “Të përmendurve nuk u dihet mirë identiteti i tyre, prandaj do të ishte mirë që të dërgoheshin për qëndrim në Gjinokastër”,⁷⁰ “Na duket i dyshimtë e në kontakt me agjentë të legatës jugosllave”;⁷¹ “Lutemi na autorizoni internimin e tij në fortesën e Gjirokastrës ose ekspulsim jasht shtetit”.⁷²

Në cilat vende të Shqipërisë kërkonin të vendoseshin shqiptarët e ardhur nga Jugosllavia?

Nga verifikimi i njoftimeve që prefekuratat i përcillnin Ministrisë së Punëve të Brendshme, rezulton se 12 individë nuk kishin shprehur ndonjë dëshirë për vendin në të cilin do të donin të jetonin. Ndër ta, përfshiheshin edhe tre shqiptarë, të konsideruar të dyshimtë, nga të cilët dy prej tyre ishin internuar.⁷³

Të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme dëshmonin se gjashtë shqiptarë të arratisur nga Jugosllavia kishin kërkuar të vendoseshin në nënprefekturën e Fierit,⁷⁴ pesë prej të cilëve u ishte plotësuar dëshira. Ndërsa, për njërin prej tyre, kjo ministri shprehej se ky person duhej të kthehej mbrapsht për në Jugosllavi.⁷⁵

Po kështu, tre shqiptarë të ardhur nga viset shqiptare në Jugosllavi kërkuan të vendoseshin në Fushë-Krujë.⁷⁶ Dy nga këto kërkesa u

⁶⁹ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64/a, fl. 305. Telegram shifër nr. 161 Res. i zëvendësprefektit të Korçës, kapiten Sh. Borrshi d. v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Korçë, 20 qershor 1928.

⁷⁰ *Po aty*, fl. 345. Telegram shifër nr. 3/113 i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi, për Zyrën Sekrete të MPB-së, Kukës, 9 korrik 1928.

⁷¹ *Po aty*, fl. 354. Kopje shkrese (njoftim) e nënkomisarit të Policisë së Tiranës, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurisë Botore në MPB, Tiranë, 14 korrik 1928.

⁷² *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64, fl. 240. Telegram shifër nr. 124 Res. i prefektit të Korçës, R. Jella d.v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Korçë, 22 maj 1928.

⁷³ *Po aty*, fl. 240. Telegram shifër nr. 124 Res. i prefektit të Korçës, R. Jella d.v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Korçë, 22 maj 1928; *po aty*, fl. 255. Telegram shifër nr. 3/86 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Tiranë, 31 maj 1928.

⁷⁴ *Po aty*, fl. 210. Telegram shifër nr. 3/71 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për MPB-në, Kukës, 14 maj 1928.

⁷⁵ *Po aty*, fl. 229. Telegram shifër i MPB-së për prefekturën e Kosovës, Tiranë, 19 maj 1928.

⁷⁶ *Po aty*, fl. 214. Telegram shifër nr. 3/72 Res. i prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi d.v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Kukës, 15 maj 1928.

plotësuan,⁷⁷ ndërsa për personin e fundit nuk u mor një vendim përfundimtar.

Kërkesat e tre shqiptarëve të tjerë për t'u vendosur në Shkodër – ku madje njëri prej tyre kishte ardhur së bashku me bashkëshorten e tij serbe – u miratuan nga kjo ministri.⁷⁸ Ndërkohë, për dy shqiptarë të tjerë, të cilët kërkuan që të vendoseshin në Shënvllash të Durrësit, kërkesa e njërit prej tyre u miratua, ndërsa për personin tjetër, dokumentacioni nuk jep të dhëna mbi vendimin e marrë përfundimisht. Po ashtu, edhe për tre shqiptarë të tjerë të ardhur nga Jugosllavia, të cilët kërkuan të vendoseshin në Tiranë, kërkesat e tyre u shqyrtuan rast pas rasti: njëra u pranua, ndërsa për dy të tjerat u vendos që të shqyrtoheshin më vonë.⁷⁹

Kërkesat e shqiptarëve të ardhur nga viset etnike në Jugosllavi të cilët dëshironin të vendoseshin në kryeqytetin shqiptar, shqyrtoheshin në mënyrë tepër rigoroze.⁸⁰ Kjo procedurë justifikohet me faktin se në Tiranë ndodheshin institucionet qendrore të shtetit shqiptar. Në përgjithësi, pas një hetimi të imët, vetëm pak prej këtyre kërkesave miratoheshin nga Zyra Sekrete e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ata që arrinin të kalonin këtë filtër ishin zakonisht persona me lidhje familjare të afërta me personalitete me origjinë nga viset etnike në Jugosllavi, të cilët mbanin poste të rëndësishme në institucione të larta të shtetit shqiptar.

Edhe nga shtetas të kombësive të ndryshme, që kishin hyrë në territorin e shtetit shqiptar nga Jugosllavia, pati kërkesa për të qëndruar në Shqipëri ose për t'u larguar në drejtim të Turqisë dhe Bullgarisë. Nga

⁷⁷ *Po aty*, fl. 225. Telegram shifër i MPB-së për prefekturën e Kosovës, Tiranë, 18 maj 1928.

⁷⁸ *Po aty*, fl. 216. Telegram shifër i ministrit të Punëve të Brendshme, K. Kotta d.v., për prefekturën e Kosovës dhe prefekturën e Shkodrës, Tiranë, 17 maj 1928; *po aty*, fl. 245. Telegram i ministrit të Punëve të Brendshme, K. Kotta d.v., për prefekturën e Kosovës dhe prefekturën e Shkodrës, Tiranë, 24 maj 1928.

⁷⁹ *Po aty*, fl. 279. Telegram shifër i MPB-së për prefekturën e Kosovës, Tiranë, 7 qershor 1928; *po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64/a, fl. 316. Shkresë nr. 93/II Res. e prefektit të Tiranës për Zyrën Sekrete të MPB-së, Tiranë, 23 qershor 1928; *po aty*, fl. 317. Telegram shifër i Zyrës Sekrete të MPB-së për prefekturën e Kosovës, Tiranë, 26 qershor 1928.

⁸⁰ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64/1, fl. 671. Shkresë nr. 246/ I Res. e komisarit të Policisë së Qendrës së Tiranës, Xhafer Preza, për Zyrën Sekrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Tiranë, 29 dhjetor 1928; *po aty*, fl. 718. Shkresë nr. 246/II Res. e komisarit të Policisë së Qendrës së Tiranës, Xhafer Preza, për prefekturën e Tiranës, 2 janar 1929.

shqyrtimi i dokumentacionit arkivor rezulton se për tri kërkesa të paraqitura, nga të cilat, dy prej tyre ishin shqiptarë dhe një tjetër me origjinë boshnjake,⁸¹ autoritetet shqiptare vendosën që fillimisht të miratonin kërkesat e dy prej aplikantëve, por më vonë rezultoi se këta persona ishin të dyshimtë, prandaj miratimi i dhënë më herët u anulua.⁸² Ndërkaq, miratimi i kërkesës së aplikantit të tretë u refuzua që në fillim të procedurës. Po kështu, tre shtetas jugosllavë me origjinë maqedonase/bullgare kërkuan të aplikonin për pasaportë dhe viza pranë legatës bullgare në Tiranë. Mirëpo, meqenëse konsideroheshin të dyshimtë, kërkesa e tyre u refuzua nga autoritetet e shtetit shqiptar. Shumica e shtetasve jugosllavë me origjinë sllave, në përgjithësi dëboheshin në drejtim të Greqisë.⁸³

Nga shqyrtimi i rasteve të mësipërme, rezulton se, me përjashtim të një rasti të vetëm, kur një shqiptar i ardhur u përpoq që të luante me shërbimet sekrete, në të gjitha rastet e tjera autoritetet drejtuese të shtetit shqiptar, edhe kur kishin dyshime të forta për shqiptarë që vinin nga Jugosllavia, vendosën të mos i kthenin në Jugosllavi. Për shqiptarët që konsideroheshin të rrezikshëm për interesat e shtetit shqiptar, synohej dëbimi i tyre në drejtim të Greqisë ose të Turqisë. Ndërsa, për rastet e tjera më pak të rrezikshme, ata mbaheshin të internuar, kryesisht në qytete që ndodheshin në pjesën qendrore të Shqipërisë së Jugut dhe pranë kufirit me Greqinë. Ndërkaq, për shtetasit jugosllavë me origjinë sllave, për të cilët ekzistonte qoftë edhe dyshimi më i vogël, ata dëboheshin menjëherë nga territori i Shqipërisë, duke iu dorëzuar zyrtarisht autoriteteve kufitare jugosllave.⁸⁴

Kërkesat e shqiptarëve që vinin nga Kosova për t'u vendosur në territorin e prefekturës së Kosovës shqyrtoheshin në mënyrë mjaft të

⁸¹ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64/a, fl. 312. Telegram shifër nr. 108 Res. i prefektit të Vlorës, Q. Bodinaku, për Zyrën Sekrete të MPB-së, Vlorë, 24 qershor 1928.

⁸² *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64, fl. 240. Telegram shifër nr. 124 Res. i prefektit të Korçës, R. Jella d.v., për Zyrën Sekrete të MPB-së, Korçë, 22 maj 1928.

⁸³ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64/a, fl. 304. Telegram i Zyrës Sekrete të MPB-së për prefekturën e Beratit dhe prefekturën e Gjirokastrës, Tiranë, 20 qershor 1928; *po aty*, fl. 306. Telegram i Zyrës Sekrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme për prefekturën e Korçës, Tiranë, 21 qershor 1928.

⁸⁴ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64, fl. 294. Telegram shifër i MPB-së për prefekturën e Kosovës, Tiranë, 14 qershor 1928; *po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64/a, fl. 337. Telegram shifër nr. 36/116 i MPB-së për prefekturën e Beratit, Tiranë, 4 korrik 1928.

kujdesshme.⁸⁵ Pranimi i tyre ishte i kufizuar për shkak se kjo prefekturë ndodhej pranë kufirit me Jugosllavinë dhe ekzistonte rreziku i organizimit të ndonjë lëvizjeje kundër shtetit shqiptar. Në tërësi, nga dokumentacioni rezulton se, gjatë kësaj periudhe, qeveria shqiptare pranoi kërkesat e katër shqiptarëve të arratisur që të qëndronin në prefekturën e Kosovës.⁸⁶

Në përgjithësi, autoritetet drejtuese të shtetit shqiptar nuk praninin që shqiptarët e arratisur nga Jugosllavia, për të cilët kishte dyshime, të instaloheshin përfundimisht në territorin e prefekturës së Kosovës. Në këtë kontekst, në një komunikim të prefekturës së Kosovës me Ministrinë e Punëve të Brendshme kërkohet që rreth 15 familje shqiptare me origjinë nga Kosova, të vendosura përkohësisht në territorin e nënprefekturës së Tropojës, të cilat konsideroheshin të rrezikshme për autoritetet vendore të kësaj prefekturë, duhej të zhvendoseshin nga kjo zonë dhe të instaloheshin në brendësi të Shqipërisë.⁸⁷ Kjo kërkesë mori miratimin nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Cilat ishin afatet e përgjigjeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme drejtuar prefekturave për shqiptarët e ardhur nga Jugosllavia?

Nga fondet e Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitet 1928-1929, patëm mundësinë që të ndjekim hollësisht procedurën e trajtimit të 61 rasteve të personave që kishin hyrë nga Jugosllavia në territorin e Shqipërisë, shumica e të cilëve nuk kishin asnjë lloj dokumenti me vete. Për këto raste, zakonisht drejtuesit e prefekturave i kërkonin kësaj ministrie një autorizim për mënyrën e veprimit. Afati i përgjigjes zyrtare

⁸⁵ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64/1, fl. 716. Telegram nr. 138/4 i prefektit të prefekturës së Kosovës, Qazim Bodinaku, për Ministrinë e Punëve të Brendshme, Kukës, 11 janar 1929.

⁸⁶ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64, fl. 289. Shkresë nr. 3/90 e prefektit të prefekturës së Kosovës, N. Taçi, për Zyrën Sekrete të MPB-së, Kukës, më 2 qershor 1928; *po aty*, fl. 263. Telegram shifër i MPB-së për prefekturën e Kosovës, Tiranë, 3 qershor 1928; *po aty*, fl. 302. Telegram shifër i MPB-së për prefekturën e Kosovës, Tiranë, 19 qershor 1928.

⁸⁷ *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 64/1, fl. 687-688. Shkresë nr. 138/I res. e prefektit të prefekturës së Kosovës, Q. Bodinaku, për Zyrën Sekrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Kukës, 28 dhjetor 1928.

të Zyrës Sekrete të ministrisë për 35 raste* paraqitej si më poshtë: në pesë raste, kjo zyrë iu përgjigj kërkesave të prefekturave brenda ditës; në 12 raste një ditë pas marrjes së kërkesës; në dhjetë raste të tjera brenda dy ditësh; ndërsa në katër raste të tjera, brenda tri ditësh. Ndërkohë që për një rast, përgjigjja u dha pas katër ditësh, dhe vetëm në dy raste, ajo u dha pas shtatë ditësh.

Duke shqyrtuar me kujdes përgjigjet zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme ndaj kërkesave të prefekturave, për rastet e shqiptarëve të shpërngulur nga Jugosllavia që hynë në territorin e shtetit shqiptar, arrihet në përfundimin se drejtuesit e kësaj ministrie, veçanërisht Spiridon Kacarosi, i cili drejtonte Zyrën Sekrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dëshmonin një ndjenjë përkushtimi, korrektësie dhe serioziteti të lartë në kryerjen e detyrës së ngarkuar nga shteti shqiptar. Ky funksionar, së bashku me drejtuesit e prefekturave, tregonin një nivel të lartë gjatë komunikimit të përditshëm zyrtar, si dhe shquheshin për përdorimin e një gjuhe të qartë dhe lakonike. Mënyra e konceptimit të shkresave zyrtare nga funksionarët e kësaj ministrie, si dhe drejtuesit e prefekturave gjatë kësaj periudhe, mbetet një model pozitiv në historinë e institucioneve të shtetit shqiptar dhe një pikë referimi nga e cila mund të përfitohet edhe në ditët e sotme.

Burime e bibliografi:

Arkiva:

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

- Fondi 152, Viti 1928, Dosja 64;
- F. 152, V. 1928, D. 64/1;
- F. 152, V. 1928, D. 64/a.

Botime dokumentare:

Libri i Qarkoreve të Shtetit Shqiptar i Vitit 1922-1923, nr. 4, 5. Botim i Ministrisë së Punëve të Mbrendshme. Tiranë: Tirana, 1923.

Fletore Zyrtare, nr. 50, Vjeti VIII. Botim i Ministrisë së Punëve të Mbrendshme. Tiranë: 16 shtator 1929.

* Për rastet e tjera nuk kemi mundur të gjejmë informacion mbi datat kur kishte nisur nga prefekturat, procedura e shqyrtimit të tyre.

Literaturë:

- Historia e Shqipërisë*, vëll. II. Botim i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave të RPSSH, Tiranë: 8 Nëntori, 1984.
- HOTI, Izber. *Qëndrimi i diplomacisë italiane ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve (1930-1941)*. Prishtinë: [mungon shtëpia botuese], 1997.
- KONTOS, Joan Fultz. *Red Cross – Black Eagle: A Biography of Albania's American School*. Boulder, Co: East European Monographs (distributed by Columbia University Press). New York: 1981.
- LUTFIU, Skender. “Shpërngulja e popullsisë shqiptare nga Mbretëria e Jugosllavisë dhe vendosja e tyre në Monarkinë Shqiptare faktor determinues në raportet midis dy vendeve 1928-1939”. Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore *Shqipëria mes Dy Luftërave Botërore: Aspekte të politikës, të së drejtës, shoqërisë dhe kulturës shqiptare në vitet 1925-1939*, organizuar nga Instituti i Historisë (ASH) dhe Fakulteti Drejtësisë (UT) më 14 dhjetor 2023.
- OSMANI, Jusuf. *Kolonizimi, reforma agrare dhe shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova (1918-1941) (Dokumente): Kolonizimi*, vëll. I. Prishtinë: pa botues, 2016.
- PURELLKU, Halim. “Shpërngulja e organizuar e shqiptarëve nga Jugosllavia në Turqi në vitet '30-të të shek. XX dhe qëndrimi i Mbretërisë Shqiptare”. Në *100 vjet Pavarësi*. Aktet e konferencës shkencore ndërkombëtare, vëll. II. Përgatiti për botim akademik Beqir Meta. Tiranë: Botimet albanologjike, 2014.
- SELENICA, Teki. *Shqipëria më 1927*. Tiranë: Tirana, 1928.
- SHKOZA, Haxhi. *Financat e Shqipnis (1839-1934)*. Tiranë: Nikaj, 1935.
- SHTYLLA, Zamir. “Shpërnguljet me dhunë të shqiptarëve nga Kosova dhe viset e tjera ndërmjet dy luftërave botërore (1918-1941)”. Në *Çështja e Kosovës – Një problem historik dhe aktual*. Përmbledhje e akteve të simpoziumit të mbajtur në Tiranë më 15-16 prill 1993. Organizuar nga Instituti i Historisë – Prishtinë dhe Instituti i Historisë – Tiranë. Tiranë: 1996.
- SOTA, Jani. “Kontributi i mërgimtarëve kosovarë për historinë dhe kulturën e Myzeqesë (1912- 1945)”, *Kosova*, nr. 31-32 (2009).

- SWIRE, Joseph. *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie*. Përkthyer nga Kujtim Ymeri. Tiranë: Dituria, 2005.
- VERLI, Marenglen. *Kosova në vështrim enciklopedik*. Tiranë: Toena, 1999.
- VERLI, Marenglen. *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë (1918-1941)*. Tiranë: Iliria, 1992.
- VICKERS, Miranda. *Shqiptarët – Një histori moderne*. Përkthyer nga Xhevdet Shehu. Tiranë: Bota Shqiptare, 2008.

Shtypi:

- Shqipëtari i Amerikës*, nr. 36, Korçë: 23 qershor 1923.
- The Near East and India*, London: 1926.

PROF. ASOC. DR. SALI KADRIA

Institute of History / Academy of Sciences of Albania
kadriasali@gmail.com

S u m m a r y

THE ALBANIAN STATE'S POLICY TOWARD ALBANIANS FROM KOSOVO AND OTHER ETHNIC ALBANIAN REGIONS IN YUGOSLAVIA WHO MIGRATED TO ALBANIA DURING 1928–1929

This scientific article provides information of interest regarding the migration process of Albanians from Kosovo and other Albanian ethnic areas in Yugoslavia, as well as how they were treated by the Albanian state during the years 1928-1929. The article details the procedures followed by the Albanian state authorities towards emigrants of all categories, from the moment they entered the country's borders until they were settled in locations designated by the Albanian state.

The article highlights that in some cases, prefects attempted to guide the Ministry of Internal Affairs on the final stance to be taken in various cases. The article also provides information about the reasons presented by individuals entering Albania from Yugoslavia, with the majority belonging to those fleeing persecution by Serbian/Yugoslav authorities. Detailed data is presented on the number of Albanians and non-Albanians who escaped

from Yugoslavia to Albania, the border sectors of the country's prefectures where the largest influx of Albanians occurred, and the period during which most of these departures from Yugoslavia took place. The article emphasizes that the largest group of Albanians who left their homeland came from the western part of Kosovo (Dukagjini Plain), which was near the border with Albania.

It concludes that even the fact of the difficult economic, social, and political situation Albania was going through, the Albanian state decided to shelter and support all Albanians fleeing from Yugoslavia. Despite the strict procedures followed by the Albanian authorities for verifying Albanians entering Albania's territory, the Albanian state did not hand over any Albanians to the Yugoslav state. Meanwhile, for foreign citizens of non-Albanian nationality, a different policy was applied. If there was even the slightest suspicion regarding foreigners, they were immediately expelled from Albania, usually through the territory of Saranda towards Corfu, Greece.

Key words: Albanian emigrants, Albania, Kosovo, Yugoslavia, Secret Office of the Ministry of Internal Affairs, Prefecture of Kosovo, Directorate of Emigration in Albania.

